



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

---

Numri i lëndës: 2020:064358

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05790740

**P.nr.379/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË– DEGA NË ISTOG - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurve L.H, i akuzuar për shkak të veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nën par.1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, të pandehurit S.K, i akuzuar për shkak të veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nën par.1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, dhe të pandehurit V.S, i akuzuar për shkak të veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nën par.1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.407/20 të datës 29.12.2020, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **22.04.2024**, në praninë e Prokurorit të Shtetit Sadije Muriqi, dhe të pandehurve L.H, S.K dhe V.S, të njëjtën ditë, mori dhe shpalli, ndërsa me datë 20.05.2024, përpiloi, këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të pandehurit:**

- L.H**, nga i ati K. dhe e ëma S. e gjinisë Z., i lindur me ... ne Gj., ku edhe banon Lagja “Dheu i Bardhë” Komuna G., i pa martuar, ka te kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes se mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, aktualisht gjendet në institucionet e Shërbimit Korrektues të Kosovës, në mbajtje të dënimit me burgim për një vepre tjetër penale.
- S.K**, nga i ati I. dhe e ëma F., e gjinisë A., i lindur me ... në Gj. ku dhe banon të Xh. e qytetit nr.20, Komuna Gj., i pa martuar, ka te kryer shkollën fillore, i punësuar, i gjendjes se dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit të lëshuar nga autoritetet e shtetit të Bosnja dhe Hercegovina me numër personal ...boshnjak, shtetas i Bosnjës dhe Hercegovinës, aktualisht gjendet në institucionet e Shërbimit Korrektues të Kosovës, në mbajtje të dënimit me burgim për një vepre tjetër penale.
- V.S**, nga i ati Edhe e ëma H, e gjinisë B., i lindur me ... në Gj. ku dhe banon, rr. “Isa Kastrati” nr.5, Komuna Gj., i pa martuar, ka te kryer shkollën fillore, i punësuar, i

gjendjes se dobët ekonomike, me numër personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, aktualisht gjendet në institucionet e Shërbimit Korrektues të Kosovës, në mbajtje të dënimit me burgim për një veprë tjetër penale

## JANË FAJTOR

### Sepse:

#### **Të pandehurit L.H, S.K dhe V.S :**

1. Me datë 10.02.2020, rreth orës 11:30 minuta, në Burgun e Dubravës Komuna Istog, pikërisht në pavijonin nr.2 me dashje dhe në bashkëveprim i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit B.H në atë mënyrë qe ditën kritike përderisa i dëmtuari B., i cili ishte po ashtu në vuajtje të dënimit ishe duke shpërndarë mjetet higjienike në korridorin e pavijonit 2, aty fillimisht i afrohet i pandehuri S. duke kërkuar me tepër mjete higjienike dhe pas një mosmarrëveshje mes tyre ky i fundit e sulmon të dëmtuarin ku pastaj ndërhyjnë edhe të pandehurit L. dhe V. dhe të tre se bashku e sulmojnë fizikisht të dëmtuarin Bujar duke e goditur me grushte në kokë dhe fytyrë ku si pasojë e kësaj i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore, në pjesën e majtë zverkore të kokës dhe përreth syrit të majtë.

- me çka në bashkëkryerje kanë kryer **veprën lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1 lidhur me par.1 nën par. 1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

#### **I pandehurit V.S:**

2. Me datën 10.02.2020, rreth orës 11:30 minuta, në Burgun e Dubravës Komuna Istog, pikërisht në pavijonin nr.2 me send qe mund të shkaktojë lëndime të rënda trupore, tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore te dëmtuarit B.M në atë mënyrë qe ditën kritike në momentin kur tre të pandehurit sipas dispozitivit të parë e sulmojnë fizikisht B.H, me të dëgjuar një zhurmë në korridorin e pavijonit nr.2, nga dhoma në të cilën po e vuan dënimin, del i dëmtuari Burim dhe ndërhyjnë me qëllim qe t'i ndaj, të njëjtin i pandehuri Valmir e godet në kokë me dorezë metalike me ç'rast i shkakton lëndime të lehta trupore.

- me çka ka kryer veprën penale **lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së.**

#### **I pandehuri S.K:**

3. Me datë 10.02.2020, rreth orës 11:30 minuta, në Burgun e Dubravës Komuna Istog, pikërisht në korridorin e pavijonit nr.2, me dashje përdorë forcën ndaj personit tjetër dhe atë të dëmtuarit B.M në atë mënyrë qe ditën kritike në momentin kur i pandehuri S. se bashku me dy të pandehurit e tjerë sipas dispozitivit të parë e godasin me grushte B.H, me të dëgjuar një zhurmë nga dhoma e tij del i dëmtuari Burim dhe në momentin kur i njëjti ndërhyjnë qe t'i ndajë këta, i pandehuri S.e sulmon të njëjtin duke e goditur me grushte në pjesë të ndryshme të trupit.

- me çka ka kryer veprën penale **sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së**.

**I pandehuri L.H:**

4. Me datë 10.02.2020, rreth orës 11:30 minuta, në Burgun e Dubravës Komuna Istog, pikërisht në korridorin e pavijonit nr.2, me dashje përdorë forcën ndaj personit tjetër dhe atë të dëmtuarit B.M në atë mënyrë që ditën kritike në momentin kur i pandehuri L se bashku me dy të pandehurit sipas dispozitivit të parë e godasin B.H, me të dëgjuar një zhurmë nga dhoma në të cilën po e vuan dënimin del i dëmtuari B. dhe në momentin kur i njëjti ndërhyrë që t'i ndaj këta, i pandehuri L. e sulmon të njëjtin duke e goditur me grushte në pjesë të ndryshme të trupit.

- me çka ka kryer veprën penale **sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së**.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenet e lartcekura të veprave penale dhe dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 31, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 46, 47, 48, 49, 69, 70, të KPRK-së dhe nenin 242, 364 dhe 369 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurve ju:

**CAKTON**

- Të pandehurit **L.H**, për veprën penale nga dispozitivi një (1) i këtij aktgjykimi, i caktohet dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro; për veprën penale nga dispozitivi katër (4) i këtij aktgjykimi, i caktohet dënim me gjobë në shumë prej njëqind (100) euro.
- Të pandehurit **S.K**, për veprën penale nga dispozitivi një (1) i këtij aktgjykimi, i caktohet dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro; për veprën penale nga dispozitivi tre (3) i këtij aktgjykimi, i caktohet dënim me gjobë në shumë prej njëqind (100) euro.
- Të pandehurit **V.S**, për veprën penale nga dispozitivi një (1) i këtij aktgjykimi, i caktohet dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro; për veprën penale nga dispozitivi dy (2) i këtij aktgjykimi, i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve.

**Gjykata konform nenit 76, par. 1 dhe 2 të KPRK-së, të pandehurve, ju shqipton:**

**DËNIM UNIK  
ME GJOBË DHE BURGIM**

- I.** Ashtu që, të pandehurit **L.H**, i shqiptohet dënim unik me gjobë në shumë prej treqind (300) euro, të cilën gjobë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Ashtu që, të pandehurit **S.K**, i shqiptohet dënim unik me gjobë në shumë prej treqind (300) euro, të cilën gjobë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III.** Ashtu që, të pandehurit **V.S**, i shqiptohet dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro, të cilën gjobë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I shqiptohet edhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, *i cili dënim me burgim, do të jetë i kushtëzuar, nuk do të ekzekutohen*, nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen, vepër tjetër penale
- Nëse të pandehurit, nuk mundën apo nuk dëshirojnë t'i paguajnë dënimet me gjobë në afatin kohor të përcaktuar me lartë, atëherë dënimet me gjobë do të zëvendësohen me dënim me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ku për çdo njëzet (20) euro të gjobës, do të ju llogaritet me nga një (1) ditë burgim.
- IV.** **OBLIGOHEN** të pandehurit që secili veç e veç në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë, paushallin gjyqësor nga **njëzet (20) euro**, ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën nga **njëzet (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- V.** **Palët e dëmtuara:** B.H me adresë në rr. “Milazim Petrova ” pn, Komuna L. dhe B.M me vendbanim në F.K, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

## A r s y e t i m

### Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.407/20 të datës 29.12.2020, kundër të pandehurve L.H, i akuzuar për shkak të veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nën par.1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, të pandehurit S.K, i akuzuar për shkak të veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nën par.1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, dhe të pandehurit V.S, i akuzuar për shkak të veprave penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nën par.1.4, lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 22.04.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Sadije Muriqi dhe të pandehurit L.H, S.K dhe V.S, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se te pandehurit e kanë kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i ka mundësuar të pandehurve të deklarohen për pranimin e fajësisë apo të deklarohen të pafajshëm.

**I pandehuri L.H,** ka deklaruar se: e pranon fajësinë për shkak të veprave penale për të cilat akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është penduar për këto veprime dhe i premtos gjykatës se ne të ardhmen do të këtë sjellje të mira dhe nuk do të kryej vepra penale.

**I pandehuri S.K,** ka deklaruar se: e pranon fajësinë për shkak të veprave penale për të cilat akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është penduar për këto veprime dhe i premtos gjykatës se ne të ardhmen do të këtë sjellje të mira dhe nuk do të kryej vepra penale.

**I pandehuri V.S,** ka deklaruar se: e pranon fajësinë për shkak të veprave penale për të cilat akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është penduar për këto veprime dhe i premtos gjykatës se ne të ardhmen do të këtë sjellje të mira dhe nuk do të kryej vepra penale.

**Prokurori i Shtetit,** lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit, ka deklaruar: se pajtohet me pranimin e fajësisë, te deklaruar nga ana e të pandehurve për veprat penale për të cilat akuzohen, pranimin e kanë bërë në mënyrë vullnetare, pa ndonjë presion, me vetëdije të plotë duke i kuptuar benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pranimi ka mbështetje ne provat qe gjendet në shkresa të lëndës.

#### Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata ne rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurve, pas marrjes së mendimeve te lartcekura, si dhe se pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, par. 2 nën par. 2.1, 2.2 dhe 2.3, dhe par.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se të pandehurit, e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga të pandehurve, për veprat penale të lartcekura për te cilat janë akuzuar.

#### Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurit, t'a shpall fajtor për veprat penale për të cilën janë akuzuar dhe i ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se të njëjtit janë penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të te pandehurve, po ashtu në veprimet e tyre manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprave penale të lartcekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të fajësisë nga të pandehurit, dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes së kushteve në referim të nenit 242 par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

#### Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që për të pandehurin **L.H** si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, rrethanat personale se është penduar për kryerjen e këtyre veprave penale dhe premtimin se ne te ardhmen do të ketë sjellje të mira. Ndërsa **rrethana rënduese** ka gjetur se ka qenë i dënuar edhe me parë, me aktgjykim të formës së prerë në çështjet penale të evidentuara me numra të SMIL-it: 2020:120883, 2022:007800, 2022:041963; për të pandehurin **S.K** si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, rrethanat personale se është penduar për kryerjen e këtyre veprave penale dhe premtimin se ne te ardhmen do të ketë sjellje të mira. Ndërsa **rrethana rënduese** ka gjetur se ka qenë i dënuar edhe me parë, me aktgjykim të formës së prerë në çështjet penale të evidentuara me numra të SMIL-it: 2021:047934, 2022:117665; për të pandehurin **V.S** si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, rrethanat personale se është penduar për kryerjen e këtyre veprave penale dhe premtimin se ne te ardhmen do të ketë sjellje të mira. Ndërsa **rrethana rënduese** ka gjetur se ka qenë i dënuar edhe me parë, me aktgjykim të formës së prerë në çështjet penale të evidentuara me numra të SMIL-it: 2018:011328, 2018:062219, 2018:068722, 2019:138711. Prandaj, Gjykata në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurve siç është precizuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryerësve, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurve, të cilët do ta kuptojnë rëndësinë e veprave penale të cilat i kanë kryer dhe në këtë mënyrë të njëjtit do të reflektojnë që në të ardhmen mos të shkaktojnë veprime të ndaluara, përkatësisht mos të kryejnë vepra penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Ndërsa sipas bindjes së gjykatës, dënimi alternativ me burgim me kusht, i shqiptuar ndaj të pandehurit V.S, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të pandehuri, në afat prej një (1) viti, nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale. Është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, me të cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit me kusht sipas nenit 47 të KPRK-së, përkatësisht që të mos zbatohet dënimi për vepra penale kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepra penale.

#### Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 dhe nenit 449 të KPP-së, i ngarkoi të pandehurit secilin veç e veç me shpenzimet e procedurës të precizuara si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, i obligoi të paguajnë nga 20 euro në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

*Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike*

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**Procesmbajtësja**  
**Hale Ahmetaj**

**GJYQTARI**  
**Petrit Nrecaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*